Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 63/01
Datë: 02.03.2015

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 9, 12, 13, 14, 15, dhe 18, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 02.03.2015 nxjerr këtë:

Vendim

1. Miratohet aplikacioni për validim të kualifikimit Furrtari dhe akreditim nga institucioni Instituti për Aftësim dhe Përkrahje të Punësimit "Dituria" në Prizren.

2. Autoriteti Kombetar i Kualifikimeve është i obliguar që të njoftojë institucionin aplikues, të krijoj panelin dhe te vazhdojë procesin sipas legjislacionit në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

4. Vendimi u dërgohet të gjitha palëve të interesit.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi